



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Nr. 325 prot. Datë 17.02.2025

Nr. 1370 prot. Datë 27.022025

PROKURORIA E POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT DHE
KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. 7451 prot. Datë 27.02.2025

PROTOKOLL KOORDINIMI DHE BASHKËPUNIMI

Për garantimin e integritetit zgjedhor nëpërmjet parandalimit dhe hetimit të veprave penale gjatë periudhës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2025 për Kuvendin e Shqipërisë

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

Duke marrë në konsideratë se me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në datë 11 maj 2025, do të zhvillohen zgjedhjet për Kuvendin;

Duke njohur rëndësinë e këtyre zgjedhjeve për të ardhmen dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian;

Duke njohur faktin se për integritetin e zgjedhjeve, parandalimi dhe ndëshkimi i veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, ka rëndësi parësore;

Duke njohur interesin e lartë të qytetarëve për të zhvilluar zgjedhje të lira, të drejta dhe të ndershme;

Të bindur se për realizimin e standardeve kërkohet bashkëpunim i strukturuar dhe i qëndrueshëm midis Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;

Prokuroria e Përgjithshme (në vijim PP, Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm) e përfaqësuar nga **Prokurori i Përgjithshëm Z. Olsian Çela**, dhe

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar e përfaqësuar nga **Drejtuuesi Z. Altin Dumani**, dhe

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, (në vijim KQZ) i përfaqësuar nga **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Z. Ilirjan Celibashi**,

në vijim referuar si "Palët",

nënshkruajnë këtë Protokoll Koordinimi:

Neni 1

Objekti

Ky protokoll ka për objekt koordinimin dhe bashkëpunimin e palëve për përcaktimin e formave, mekanizmave dhe rregullave për shkëmbimin e shpejtë të informacionit, me qëllim garantimin e integritetit të procesit zgjedhor, parandalimin, identifikimin dhe ndjekjen e veprave penale që lidhen me zgjedhjet, si dhe forcimin e bashkëpunimit institucional për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe transparencës gjatë procesit zgjedhor.

Neni 2

Fushëveprimi

Ky protokoll bashkëpunimi mbulon:

- 2.1. Komunikimin e ndërsjellë të informacionit në kohë të shpejtë dhe bashkërendimin e ngushtë lidhur me hetimet e veprave penale të kryera në kuadër të zgjedhjeve.
- 2.2. Hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale të parashikuara në Kodin Penal që lidhen me procesin zgjedhor gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2025 për Kuvendin e Shqipërisë.
- 2.3. Koordinimin e shpejtë, të strukturuar dhe efektiv ndërmjet prokurorive të juridiksionit të zakonshëm, Prokurorisë së Posaçme dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 2.4. Asistencën dhe bashkëveprimin reciprok për trajtimin e rasteve, në përputhje me kompetencën ligjore përkatëse.

2.5. Sigurimin e lehtësimit të aksesit në platformat elektronike të monitorimit të zgjedhjeve.

Neni 3 **Angazhimet e Prokurorisë së Përgjithshme**

Prokuroria e Përgjithshme angazhohet për sa vijon:

- a) të ngarkojë një prokuror dhe një oficer të policisë gjyqësore pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve gjatë fushatës zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve, me qëllim koordinimin me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm;
- b) të ushtrojë ndjekjen penale, me përparësi dhe efikasitet maksimal, për të gjithë veprat penale që çenojnë zgjedhjet e lira, sistemin demokratik të zgjedhjeve, si edhe çdo veprë tjetër penale, e cila dëmton procesin zgjedhor;
- c) në përputhje me detyrimet procedurale, prokurorët të njoftojnë KQZ-në për vendimmarrjen përkatëse në rastet kur ka bërë kallëzim penal, brenda 2 ditëve nga marrja e vendimit;
- ç) t'i dërgojë KQZ-së informacion statistikor për veprat penale që kanë lidhje me zgjedhjet, duke garantuar ruajtjen e sekretit hetimor, ndalimin e publikimit të akteve dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas përcaktimeve ligjore.
- d) të trajtojë kërkesat e KQZ-së për verifikim të thelluar në zbatim të ligji nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";
- dh) të mbështesë dhe bashkëpunojë me KQZ për zhvillimin e fushatave sensibilizuese/edukuese si dhe sesioneve trajnuese për identifikimin e shkeljeve penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.

Neni 4 **Angazhimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve angazhohet për sa vijon:

- a) të përcjellë në kohë të shpejtë informacione dhe kallëzime që lidhen me krimet zgjedhore, Prokurorisë së Posaçme, për çështjet objekt i kompetencës së saj, prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, për çështje objekt i kompetencës së tyre, dhe bashkëpunimin në hetimin e shpejtë dhe objektiv të çështjeve, duke vënë në dispozicion informacionin dhe dokumentacionin që mund të disponojë lidhur me, elementet thelbësore të faktit dhe veprën penale të dyshuar se është shkelur, gjeneralitetet dhe çdo gjë tjetër që vlen për identifikimin e personit/subjektit zgjedhor

të cilit i atribuohet fakti (kur është e mundur); identifikimin e zonës elektorale/qendrës së votimit ku dyshohet se është kryer vepra (nëse lidhet me veprën penale); datën në të cilën dyshohet se është kryer vepra;

- b) të dërgojë brenda afateve formularët e vetëdeklarimit dhe relacionin apo dokumentacionin shoqërues, nëse ka, për verifikim të thelluar, në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- c) të zhvillojë sesione trajnimi për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve për aktorët kryesorë të përfshirë në procesin zgjedhor;
- ç) të zhvillojë fushata sensibilizuese për edukimin e shoqërisë, me synim njohjen e ligjit, parandalimin dhe denoncimin e veprave penale që prekin sistemin e zgjedhjeve.
- d) të krijojë akses të drejtëpërdrejtë për përfaqësuesit e autorizuar të Prokurorisë së Posaçme dhe atyre të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, në Ndërfaqen e Raportimit të Aktiviteteve Publike (NRI) të KQZ-së, dhe platforma të tjera që monitorojnë dhe evidentojnë shkeljet e mundshme gjatë fushatës dhe administrimit të zgjedhjeve;
- dh) të mundësojë praninë e përfaqësuesve të autorizuar të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme pranë strukturës së monitorimit të zgjedhjeve në KQZ.

Neni 5

Angazhimet e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar angazhohet për sa vijon:

- a) të caktojë një prokuror dhe/ose hetues pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve gjatë fushatës zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve, me qëllim koordinimin me këtë institucion;
- b) të koordinojë me KQZ për mbledhjen e denoncimeve dhe analizimin e atyre që lidhen me juridiksionin e Prokurorisë së Posaçme me qëllim ndjekjen penale të autorëve të veprave penale në këtë proces dhe parandalimin e mundshëm të kryerjes së tyre.
- c) të përcjellë në KQZ, kur kërkohet prej saj, informacion për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, për aq sa është e mundur pa çënuar sekretin hetimor.

Neni 6
Angazhime të Përbashkëta

Palët marrin përsipër:

- a) të shkëmbejnë informacion nëpërmjet pikave të kontaktit të përcaktuara;
- b) të garantojnë mbrojtjen dhe konfidencialitetin e informacionit, provave, akteve dhe/ose të dhënave të tjera deri në përfundimin e hetimeve paraprahe;
- c) të zhvillojnë së bashku aplikacione kompjuterike që mundësojnë denoncimin e shkeljeve të ligjit gjatë gjithë periudhës zgjedhore dhe në ditën e zgjedhjeve, duke përfshirë të gjithë qytetarët, shoqërinë civile dhe subjektet e tjera të interesuara.

Neni 7
Konfidencialiteti

Palët angazhohen të mbrojnë informacionin e ndarë mes tyre në kuadër të këtij protokolli duke respektuar rregullat e sekretit hetimor dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Neni 8
Personi i kontaktit


Palët, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Protokolli, do të caktojnë personat e kontaktit që do të kujdesen për zbatimin e tij.

Neni 9
Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll Koordinimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga palët.
2. Ky Protokoll Koordinimi përpilohet në 6 (gjashtë) kopje dhe secila palë mban nga dy kopje të njëjta.

PROKUROR I PËRGJITHSHËM

OLSIAN ÇELA



**DREJTUES I PROKURORISË SË POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT DHE
KRIMIT TË ORGANIZUAR**

ALTIN DUMANI

KOMISIONERI

ILIRJAN ÇELIBASHI

